



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL DURRËS

Data 06.02.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – e hapur e thjeshtuar mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE DHE VENDOSJE GROPË SEPTIKE PËR
NEVOJAT E ZYRAVE TË REJA MODULARE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 44423700-8 - Elementë pusetash,

Tipi i Procedurës: E hapur, e thjeshtuar

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,969,821 *(Tre milion e nwnwtqind e gjashtwdhjetw e nwnwtw mijw e tetwqind e njwzet e njw), lekë pa TVSH.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor "**Autoriteti Portual Durres**", ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2020-2021-2022), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të pakten një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, dhe në nenin 43 pika 2.a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të të ardhurat", i ndryshuar, neni 29 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Kapaciteti teknik:

2.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data e publikimit të njoftimit të kontrates së shpallur, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, pika 4 dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 40 % të vlerës së perlllogaritur të kontrates, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

3. Licencat profesionale:

Subjektet pjesmarrëse në konkurim duhet të zotërojnë, Licenca profesionale të Zbatimit, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, "Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi" i ndryshuar të lëshuar nga Komisioni i Posaçëm i dhënies së licencave profesionale, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 A, Punime gjurmimi në tokë.**
- NP-7 A, Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.**
- NS-2 A, Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri mirëmbajtja e tyre.**
- N.S.18-A, Punime topogjeodezike;**

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet licenca profesionale.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturs dhe Energjise, (ose Ministrise

kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM- nr. 42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtimi” i ndryshuar, projekt-preventivin e projektit, VKM nr. 629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i ndryshuar, Udhëzim nr.3, datë 15.2.2001 “Për Mbikëqyrjen Dhe Kolaudimin E Punimeve Të Ndërtimit”.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 A	Punime gjurmimi në tokë	- Germim dheu me ekavator	0-20 mln leke	431,421.44
NP-7 A	Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje	- F.v tuba drenazh Ø125-110mm , pvc	0-20 mln leke	18,000.0
NS-2A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri mirëmbajtja e tyre.	F.v Grope septike me tre dhoma per 300 persona	0-20 mln leke	3,020,000.0
N.S.18-A	Punime topogjeodezike; (Konsiderohet zbatimi... punime topogjeodezike në objekte inxhinierike)	Kërkuar për arsye të zbatimit të punimeve të piketimit për realizimin e objektit në teresi: <ul style="list-style-type: none"> • Piketimi i punimeve të germimit. • Piketimi i punimeve të montimit të gropes septike 	A, 0-20 milionë lekë	

4. Stafi dhe Fuqia Punëtore

4.1 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të stafit për realizimin dhe zbatimin e shërbimit. Numri i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më i vogël se **7 punonjës** të siguruar për tre muajt e fundit nga momenti i hapjes së ofertës.

Lidhur me personelin e kërkuar, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Vërtetim nga Administrata Tatimore, si edhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/SIG-25, për të gjithë periudhën e kërkuar.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë disponibilitetin e numrit të kërkuar të punonjësve për gjatë gjithë periudhës së realizimit të shërbimit, konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për një punësim të paktën 7 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, terrenin ku do të kryhen punimet si dhe grafikun e punimeve. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, llogaritjeve përkatëse që ka bërë grupi i projektimit është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë

26.10.2018). Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos (material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% te kosos. Pra numri i stafit kryesor dhe mbeshtetes eshte llogaritur ne baze te volumeve dhe grafikut te punimeve.

4.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 6 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhiner Ndertimi/Hidroteknik;
- 1 (një) Inxhiner Gjeodet

1 nje Inxhinier Ndërtimi/1 (një) Inxhinier hidroteknik	punime për mbushje dhe gërmim; punime për struktura, punime per instalimin e gropes septike
1 (një) Inxhinier Gjeodet	Per piketimin e gropes septike

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit stafit kryesor dhe mbështetës të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merrem masa për ndërprerjen e kontratës.

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021,I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin inxhinierik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierit të ndërtimit,gjeoteknik, gjeodet, hidroteknik, mjedisi, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit,

sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit kryesor të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

4.3 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit të tij, të cilët duhet të figurojnë në list pagesën e shoqërisë ofertuese, për të gjithë periudhën e kërkuar, të paktën:

- 1 shofer
- 1 drejtues manovrator,
- 1 hidraulik,
- 2 puntorë

Lidhur me personelin e kërkuar, Ofertuesi duhet të paraqesë, kontratat e punës, çertifikata /dokumenti që provon kërkesat e mësipërme, si dhe Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/Sig-25, për të gjithë periudhën e kërkuar.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021,I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe specifikimeve të punimeve.

4.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji Makinerive	SASIA	PRONESIA
Autovinc kapaciteti mbajtës minimum 1.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qira

<i>Palankola me gjatesi 6 m per suport skarpate gjate germimit</i>	<i>5ton</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Fadrome</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Eskavator mbi 2.5ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Gjenerator korenti</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Pompë uji për pastrim</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Mjet eskavator i pajisu me vibrator per ngulje palankolash me force ngulese mbi 600Kn dhe moment ekscentrik 8KnM</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Matrapik</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Instrument topografik</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Paisje per largimin e ujerave nentoksore me sistem gjilperthithese (Sistemi Well Point i paisur me pompe thithese centrifugale vetembushese me lende djegese nafte ose benzin $Q_{min}=150$ l/min, $H=10$ml, age ,kolektor dhe aksesor bashkues)</i>	<i>1 set</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Automjet teknologjik per pastrimin e pusetave te kolektoreve te KUZ e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 4 ton, e pajisur me kove hidraulike per ngarkimin e materialeve te ngurta dhe vinc me kapacitet ngrites jo me pak se 0.3 ton.</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes . Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore).

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumetimi: Mjetet e mësipërme kërkohen: Duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit dhe afatin e kryerjes se tyre.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve. Përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

4.5 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese, ku të deklarojë se, makineritë e kërkuara, nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, si dhe do të jenë në dispozicion të këtij objekti, deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Argumentimi: Kjo kerkese është vendosur bazuar në ligjin nr. 162/2020, Per prokurimin publik, mbi besueshmerine, neni 76/3/ë, 77, dhe verifikimin e informacionit të paraqitur në tender, dhe nenin 78 të ligjit të sipercituar, në rast të paraqitjes së informacionit dhe dokumentacionit me të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi. Nëpërmjet kësaj deklarate krijohet besueshmeria në dhenin dhe paraqitjen e dokumentacionit në tender, pasi shoqërite

duhet te deklarojne se makinerite do te jene ne dispozicion te objektit, per realizimin me sukses te kontrates.

4.6 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë, ku të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik, si dhe të deklarojë se do të paraqesë me shpenzimet e veta të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara në dokumentet e tenderit, pranë Entit/Autoritetit Kontraktor, në rast se do të lindi nevoja për verifikimin e tyre, përpara shpalljes së klasifikimit.

Argumentimi: Kjo kerkese eshte vendosur bazuar ne ligjin nr. 162/2020, Per prokurimin publik, mbi besueshmerine, neni 76/3/ë, 77, dhe verifikimin e informacionit te paraqitur ne tender, dhe nenin 78 te ligjit te sipercituar, ne rast te paraqitjes se informacionit dhe dokumentacionit me te dhena te rreme per qellime kualifikimi. Nepermjet kesaj deklarate krijohet besueshmeria ne dhenin dhe paraqitjen e dokumentacionit ne tender, pasi shoqerite duhet te deklarojne se makinerite do te jene ne dispozicion te objektit, per realizimin me sukses te kontrates, si dhe ne rast se do te lindin dyshime dhe nevoja per verifikimin e tyre, shoqerite duhet te paraqesin mjetet e kerkuara, me qellim verifikimin fizik te tyre.

4.7 Ofertuesi duhet të dorëzojë për grupen septike Autorizim Prodhuesi ose Distributori ne rast se do te paraqitet Autorizim Distributori operatori ekonomik ta vertetoj kete duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi / akt-marreveshje lidhur mes Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website.

a) Operatori ekonomik ofertues për gropen septike duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/it me qëllim vërtetimin e përmbushjes së gjitha kushtet dhe kërkesat e vendosura ne Specifikimet per materialet. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, dokumentet e mësipërme duhet ta paraqesë anëtari i grupit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërit FV të referuar preventivit të objektit të prokurimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose;

5. ÇERTIFIKIME TE SUBJEKTIT

5.1 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në

punë, mjedisit dhe sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te cilesise (ISO 9001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te mjedisit (ISO 14001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (ISO 45001:2018) ose ekuivalente (e vlefshme).

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjit 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që plotësojnë kërkesat e cilësisë për realizimin me sukses të kontratës

Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Afati i lëvrimit:

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e lëvrimit në përputhje me afatin kohor që është **10 ditë**, lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Grupi i Specifikimeve Teknike: